



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/80
Datë: 30.05.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të pikës 2.4 të Ligjit Nr.08/L-009 për Ratifikimin e Amendamentimit Nr. 1 të Marrëveshjes Kornizë së Kredisë të datës 14 gusht 2020, ndërmjet Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për Financimin e Projektit "Reagimi Emergjent ndaj Covid-19", shtojcës së parë, të pikës 3 të Ligjit Nr.07/L-030 për Ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë për Kredi ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës - Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj COVID-19, të nenit 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për alokimin dhe shpenzimin e mjeteve buxhetore deri në vlerën 1,768,300.93 € (një milion e shtatëqindëgjatëdhjetëetë mijë e treqind euro e nëntëdhjetëetë cent), për pagesën e obligimeve kontraktuale të krijuara me lidhjen e kontratave me 1,271 profesionistë shëndetësorë dhe staf mbështetës, lidhur me menaxhimin e situatës me COVID-19, për periudhën 15 mars - 15 qershor 2022.
2. Mjetet për zbatimin e këtij Vendimi sigurohen nga Huamarrja nga Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj COVID-19, me fond burimor 04, të ndara sipas buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë, me kod 206, nën-programi Shërbime Përkatëse Farmaceutike, me kod 71300 të specifikuar në kodin përkatës (00099), kategoria e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime".
3. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë